



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 584/B prot

Pukë, më 16, 08.2024

VENDIM

NR. 35 , datë 16.08. 2024

**“PER
DHENIEN NE PERDORIM NGA FONDI PYJOR” PER SHESHDEPOZITIMI TË
PËRKOHSHËM TË MATRIALEVE TË NDRYSHME TË SIPERFAQJES 0.2 HA NE
PARCELËN 28/A , NË EKONOMIN PYJORE MUNELLË**

Këshilli Bashkiak , në mbledhjen e tij të datës 16.08.2024, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpikat 1.1 shkronja “b” dhe 1.2, shkronjat “a” dhe “c”, nenit 54, shkronja “e”, nenit 55, pikat 3 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 “Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shtetore dhe enteve publike”, Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ne Ligjin nr.8761 data 02.04.2001 “Për miratimin e "marrëveshjes së koncensionit të formës "bot" ndërmjet ministrisë së ekonomisë publike dhe privatizimit dhe shoqërisë së të drejtës turke "ber-oner" për disa objekte të industrisë së bakrit dhe të kromit, si dhe për dhënien e disa stimujve dhe garancive për koncensionarin e kësaj marrëveshjeje”; Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 “Per transferimin ne pronesi te Bashkive të fondit pyjor e kullisor publik.”, V.K.M-ve nr. 888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhenjes ne perdorimi dhe per ndryshimin e kategorise se perdorimit ,procedurat dhe deokumentacioni perkates per ndryshimin e siperfaqeve dhe paksimin në volum nga fondi pyjor kombetar, apo zgjerimin e tyre; VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve tarifave per dhenjen ne shfrytezim/Perdorim te fondit pyjor kombetar per veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore” , Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 “Per rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesave për dhenie në perdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik”, si dhe në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të bashkise Nr.166 date 05.04.2024 për hartimin e vlersimit tekniko- ekonomik., me propozim të Kryetarit te Bashkisë pas diskutimeve në përfundim :

VENDOSI:

1. Miratimin e dhënies në përdorim nga fondi pyjor dhe kullosor të sipërfaqes prej 0.2 ha në ekonominë pyjore Munellë , ngastra 28/a ,për sheshdepozitimi të materialeve inerte të përkohshëm për subjektin BERALB shpk
2. Vlera vjetore e dhenjes ne perdorim me kontrate qeraje te jete sipas studimit te raportit te vlersimit tekniko-ekonomik te bazuar ne piken 12 shtocen 1 VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e emimeve tarifave për dhenjen në shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kombetar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”
3. Afati i dhenjes në perdorim është 10 vjet me të drejtë rinovimi
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Pyjeve, kullotave dhe Bujqesisë.
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr 139/2015 ,“Per Vetëqeverisjen Vendore”
6. Vdndimi u shpall me datë **16.08.2024**
Miratuar me 10 vota; vota pro 10 , vota kundër 0, vota abstenim 0

SEKRETAR

Hazbi **TERBUNI**



KRYETARI I KESHILLIT

Gjon **GJOKA**

